



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0415

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Panelist Individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “DWH-KOSOVA” SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të “KUVENDI KOMUNAL I KLINËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instrument Gjeodezik” me numër të prokurimit 634-25-1418-1-2-1, me 08/07/2025, mori:

Vendim

- 1. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “DWH-KOSOVA” SH.P.K. me nr. 2025/0415, e datës 27/05/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instrument Gjeodezik” me numër të prokurimit 634-25-1418-1-2-1.
- 2. Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “KUVENDI KOMUNAL I KLINËS”, ndërkaq aktiviteti i prokurimit "Instrument Gjeodezik" me numër të prokurimit 634-25-1418-1-2-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “DWH-KOSOVA” SH.P.K.
5. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 12.03.2024, "KUVENDI KOMUNAL I KLINËS" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftim për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Instrument Gjeodezik" me nr. të prokurimit: 634-25-1418-1-2-1. Ndërsa me datën 14.05.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 12,000.00 €.

Me 16.05.2025, OE "DWH-KOSOVA" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 20.05.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27/05/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "DWH-KOSOVA" SH.P.K. me nr. 2025/0415 për lidhur me aktivitetin "Instrument Gjeodezik" me nr. të prokurimit: 634-25-1418-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "DWH-KOSOVA" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

AK ka kërkuar te pajiset me GPS, i cili ka si aksesori nder te tjera edhe një Kontroller, i cili lexon matjet e GPS.

AK ne specifikimet teknike te Kontrollerit nder te tjera kërkon (citojmë): "Bateria te jete se paku 7500mAh ose jo me pak se 10 ore pune"

Kërkesa është formuluar fare qarte "7500mAh OSE 10ore pune"

Ne kemi ofruar bateri me 14 ore pune, dhe me-gjithë-atë AK skualifikon ne mënyrë abuzive ofertën tone.

Kjo i bie ndesh me vete kërkesën e tenderit e cila thotëose 10h pune. Pra sipas kërkesës se AK lihen hapur dy mundësi

a) nëse bateria është 7500mAh, edhe se nuk plotëson 10 ore pune, kërkesa konsiderohet si e përmbushur sipas AK,

b) nëse bateria përmbush 10 ore pune, edhe nëse bateria nuk është 7500mAh, kërkesa konsiderohet e përmbushur sipas AK.

AK përlehet me kërkesën e vet dhe e skualifikon ofertën qe plotëson dhe tejkalon kërkesën e AK.

Po kështu kjo kërkesë bie ndesh me nenin 28, pika 2, 6, 7, 8 dhe 9. Po ashtu bie ndesh me nenin 1 dhe 7 të LPP 04/L-042.

Nuk po lëshohemi në argumenta të tjerë, që dëshmojnë kontraditën e kërkesës, si psh.

- bateria e GPS kërkohet 6900mAh ose 10 ore pune, kurse Kontrolleri 7500mAh ose 10 ore pune ???!!!

- zhvillimi teknike kërkon energji (mAh) sa me të ulet, me rendiment (ore pune) sa me të lartë ???!!!

Kurse AK kërkon të kundërtën, energji të madhe (7500 mAh) me rendiment të vogël (10 ore pune).

Ky nen bie ndesh edhe me disa vendime të OSHP për të njëjtën kërkesë, të cilat bazuar në Res Judicata, e bëjnë aprovimin e ankimimit tëone të aplikueshëm pa u futur në gjykim.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “DWH-KOSOVA” SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim LPP të RK 04/L-042, i ndryshuar me ligjet 94/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-092, Neni 1, 7 dhe 28 - Vendimet paraprake të OSHP për kërkesën nominale të baterisë. Në i kërkojmë OSHP të rezojë vendimin e AK të datës 14.05.2025 për anulim të procedurës, të shpallë ofertën tëone të përgjegjshme, dhe të shpallë ofertën tëone për kontratë, sepse OE pjesëmarrës e kanë pranuar në mënyrë përfundimtare vendimin e AK dhe si rrjedhojë oferta e DWH - KOSOVA është e vetmja në gare. Bashkangjitur: 1. Vendimi i AK 2. Kërkesa për rishikim 3. Përgjigja e kërkesës për rishikim 4. Specifikimet e kërkuara në dosje 5. Oferta e DWH - KOSOVA SHPK.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim Arsishmeria 1 - Hudhet I pa bazuar pasi që - Tek kërkesa e AK - pjesa e Kontrollorit të instrumentit specifikohet se bateria duhet të jetë së paku 7500 mAh, ndërsa juve keni sjellë katalogun për kontrollorin ku tek specifikacionet e baterisë kapaciteti shënon 6240 mAh.

Arsishmeria 2 - Hudhet I pa bazuar pasi që ka qenë afati I sqarimit të tenderit ndërsa sa I përket të çmimi vlera e parashikuar ka qenë 12,000.000 e oferta juaj ka qenë 4,449.78 €

Arsishmeria 3 - Hudhet I pa bazuar pasi që ka qenë afati I kërkesës për rishqyrtim është I përcaktuar shumë qartë në LPP pra nuk kemi nevojë për këshillën juridike pasi që ju nuk keni ushtruar akoma ankesë në vendimin tëone . Pra bëhet fjalë vetëm për vendimin e autoritetit kontraktues që afatet kohore janë të rregulluara me ligje ku keni të drejtë ankesë brenda afatit 5 dite nga data e njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Pra këtu nuk ka të bëjë asgjë me pretendimet juaja.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 04.06.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0415/2025, ndërsa me datë 16.06.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0415/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhënë përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “DWH-KOSOVA” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0415 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigjeje në pretendime. Eksperti shqyrtues jep mendimin e tij në lidhje me pretendimin ankimor, pasi ka administruar dhe shqyrtuar me kujdes shkresat që lidhen me faktet dhe argumentet në platformën elektronike e – prokurimi, duke u bazuar në pretendimin ankimor të ngritur nga Operator ekonomik (OE) ankues DWH-KOSOVA SH.P.K, e që ndërlidhet me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 ku është kërkuar si, Operatori Ekonomik është i obliguar të paraqesë një Katalog për produktin e ofruar dhe si dëshmi është kërkuar, Katalogu duke nenvizu pajisjet me te cilën ofertohehet përfshirë edhe karakteristikat teknike, bëjmë të ditur se OE ankues në ofertën e tij ka dorëzuar katalogun, katalogu është emërtuar si (Document-DST2513942). Ndersa në B42 letrën standarde për tenderuesin eliminim, OE ankues është eliminuar lidhur se Katalogu i prezantuar pajisjet nuk plotësojnë specifikat teknike të detyrueshme në këtë rast AK nuk ka cekuar apo precizuar sakët cilat pika nuk i plotëson katalogu i dorëzuar nga OE ankues.

Më tej sqarojmë....

Pretendimi ankimor po ashtu ndërlidhet me Aneksin 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, konkretisht pika 2. Kontroller - të jetë i integruar me tastaturë alfanumerike fizike të plotë e jashtme dhe ekran HD touchscreen jo me i vogël se 5 inch. Memorie SD deri ne 128 GB Komunikimi USB, interface, Wifi, Bluetooth, NFC, dhe OTG. Bateria të jetë së paku 7500 mAh ose jo më pak se 10 orë punë dhe të jetë e integruar e brendshme-internal. Të jetë IP67.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues ka parashikuar dy alternativa për karakteristikën e baterisë, duke përdorur lidhëzën OSE, pra duke lejuar operatorët ekonomikë të ofrojnë një nga këto dy opsione:

Bateri me kapacitet së paku 7500 mAh, OSE

Bateri që garanton jo më pak se 10 orë funksionim

Operatori Ekonomik ankues, për të cilin kemi dhënë sqarime më lartë në këtë përgjigje, në katalogun e paraqitur ka ofruar pajisje me bateri që siguron kohë funksionimi prej 14 orësh, çka plotëson në tërësi kërkesën e pikës 2 të aneksit 1 për të cilën është ngrit pretendimi, pasi përmbush njërën nga dy opsionet e parashikuara. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar dhe rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim për AK i cili obligohet të veproj në harmoni me rekomandimet e ekspertëve shqyrtues.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Instrument Gjeodezik” me nr. të prokurimit: 634-25-1418-1-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “DWH-KOSOVA” SH.P.K. dhe se argumentimi në raportin e ekspertës është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “DWH-KOSOVA” SH.P.K. janë të bazuara.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Instrument Gjeodezik” me nr. të prokurimit: 634-25-1418-1-2-1, të anulohet njoftimi për anulim dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive

të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - DWH-KOSOVA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: